



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SEKTORI I MBROJTJES SË MJEDISIT

NJOFTIM

ZHVILLIMI I DËGJESËS ME PUBLIKUN PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS PËR PROJEKTIN “PORTI I INTEGRUAR I DURRËSIT, PORTO-ROMANO”.

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar, Ligji Nr. 10440, datë 07. 07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” (i ndryshuar), Vendimit Nr. 714, datë 6.11.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne VKM-në Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiive e të afateve për zhvillimin e proçedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM-së) dhe proçedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” (i ndryshuar),VKM-në Nr.247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të proçedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore”, Bashkia Durrës, njofton se do të zhvillohet Dëgjesa me Publikun, ku ftohen publiku dhe palët e interesuara që të jenë pjesëmarrës në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për projektin: “Porti i Integruar i Durrësit, Porto-Romano” me të dhënat si vijon:

- LLOJI I INSTALIMIT: NDËRTIMI I PORTIT TË INTEGRUAR NË PORTO-ROMANO, DURRËS;
- SUBJEKTI : AUTORITETI PORTUAL DURRËS;
- ADRESËN E VENDODHJES SË INSTALIMIT: PORTO-ROMANO, DURRËS;
- ADRESA ELEKTRONIKE E AKM-SË: <https://akm.gov.al/>;
- VENDI I TAKIMIT : NË AMBJENTET E UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, NË KAMPIN UNIVERSITAR, RRUGA MIQËSIA, SPITALLË, DURRËS;
- DATA E DËGJESËS: 07.12.2022, ORA 10:00.

Bazuar në VKM-në e sipërcituar, një kopje të njoftimit dhe Përmbledhjen joteknike të raportit të VNM-së të dërguar nga subjekti: "Abkons", konsulent i nënkontraktuar për kryerjen e Studimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe organizimin e Konsultimit me Publikun, mund ta gjeni në mjediset e Bashkisë Durrës, në Sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin,

KRYETAR

Emiriana Sako

